



REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRI I QEVERIS / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGJENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY			
Njësia Org. Org. Kodice Org. Unit	<u>AQP</u>	Nr. Prot. Bng Prot. Prot. No.	<u>009/19</u>
Nr. I Fazes Dr. Stravica No. Pages	<u>16/1</u>	Data: Datum: Date:	<u>26.03.2019</u>
Prokurimë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agjencia Nabavke-Central
Procurement Agency

KONTRATË PËR SHËRBIME

TITULLI I KONTRATËS:

Shfrytezimi i fotokopjeve dhe printerve me qera – Niveli lokal Lot IV

NUMRI I PROKURIMIT: AQP 18 009 211
NUMRI I MRENSHEM UA/2016 18 6489 211

PJESA B: KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA**

Agjencia Qendrore e Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe

Art House Sh.p.k numër fiskal 600231774 si dhe numrin e biznesit 70273872 (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara më poshtë:

Titulli: Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal, me numër identifikues: AQP-18-009-211

UA/2016-18-6489-2-1-1

Numri rendor i kontratës: 04/19 DPQ

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera për printim, fotokopjim dhe skanim -Niveli lokal

AQP-18-009-211 Lot IV- Regjioni IV

1.2 Kontrata hynë në fuqi nga data 01.04.2019.

1.2. Kjo kontratë publike kornize ka kohëgjatësi prej 74 muaj dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hynë në fuqi

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 206.500,00€; (Dyqind e Gjashtë mijë e Pesëqind) Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontratë" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet



4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **[shqipe]** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ekrem Rexha
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26-03-2019
Vula:	

Emri:	Behxhet Rrukiqi
Pozita:	Zyrtar Kryesor Administrativ
Nënshkrimi:	
Data:	26.03.2019
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	BLIN ZEGAR
Pozita:	CEO
Nënshkrim:	
Data:	26.05.2019
Vula:	

PJESA II E KONTRATES**KUSHTET E PËRGJITHSHME****Neni 1 Përkufizimet**

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofrues i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktuar pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteve.

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshtrohet ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndër marrë hapa të menjëhershëm për ta

përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrin. Ekzekutimi i urdhrin administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veproj në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdojë të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në

Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera-Niveli lokal Lot IV

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë specifikimin teknik të detyrueshëm si më poshtë për secilën prej kategorive të kërkuara Specifikimet teknike të detyrueshme

Pershkrimi	Printer bardhe e zi prej 1-10 perdorues
Karakteristikat	Printer A4
Shpejtesia e Printimit:	prej 45 - 50 ppm
Kapaciteti mujor I printimit:	100,000 per muaj
Memorja:	512MB
Procesori:	300 MHz
Rezolucioni I Printimit:	1,200 x 600 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	4 deri ne 8 sekonda
Kapaciteti I fleteve hyrese:	500 flete - standard
Printimi/Kopjimi ne te dy anet:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0

Pershkrimi	Printer me ngjyra prej 1-15 perdorues
Karakteristikat	Printer A4
Shpejtesia e Printimit:	prej 30 - 40 ppm
Kapaciteti mujor I printimit:	75,000
Memorja:	256MB
Procesori:	500MHz
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 1200 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	10 deri ne 15 sekonda bardh e zi dhe me ngjyra
Kapaciteti I fleteve hyrese:	550 flete
Printimi/Kopjimi ne te dy anet:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0

Pershkrimi	Printer Multifunksional bradh e zi prej 1-30 perdorues
Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4
Shpejtesia e Printimit:	prej 45 - 55 ppm
Kapaciteti mujor I printimit:	100,000 deri 150,000 per muaj
Memorja:	1GB
Procesori:	533 MHz
Hard Disk:	120 GB
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 600 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	4 deri ne 10 Sekonda
Kapaciteti I fleteve hyrese:	550 flete - standard
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Email Address Book, Scan to Computer, Color Scan, PDF, Jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	min 30 ppm
Karakteristikat e Fax'it:	Fax to Fax, Email, Address Book , Receive Fax
Mundesia e staplimit te dokumenteve:	Standard

Pershkrimi	Printer Multifunksional me ngjyre prej 1-15 perdorues
Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4
Shpejtesia e Printimit:	prej 35 - 40 ppm A4
Kapaciteti mujor I printimit:	100,000 per muaj
Memorja:	2 GB
Procesori:	1Ghz
Hard Disk:	250 GB HDD
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 600 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	5 deri ne 15 sekonda
Kapaciteti I fleteve hyrese:	550 flete - standard
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Email Address Book, Scan to Computer, Color Scan, PDF, Jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	min 30 opm
Karakteristikat e Fax'it:	Fax to Fax, Email, Address Book , Receive Fax

Pershkrimi	Fotokopje bardhe e zi prej 1-50 perdorues
Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4/A3
Shpejtesia e Printimit:	prej 30 - 35 ppm A4
Kapaciteti mujor I printimit:	90,000 printime ne muaj
Memorja:	1 GB
Procesori:	400 Mhz
Hard Disk:	160 GB
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 1200 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	10 deri ne 15 sekonda
Kapaciteti I fleteve hyrese:	2 sirtare te letres me nga 500 flete; kapaciteti I fleteve hyrese per kopjim (Document Feeder): minimum 100 fleta
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Usb, Pc, Email, Network, pdf, jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	minumum 50 ppm
Karakteristikat e Faks'it:	Standard

Pershkrimi	Fotokopje bardhe e zi prej 50-100 perdorues
Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4/A3
Shpejtesia e Printimit:	prej 55 - 65 ppm A4
Kapaciteti mujor I printimit:	200,000 printime ne muaj
Memorja:	1.5 GB
Procesori:	1GHz
Hard Disk:	250 GB
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 1200 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	3 deri ne 8 sekonda
Kapaciteti I fleteve hyrese:	2 sirtare te letres me nga 500 flete; kapaciteti I fleteve hyrese per kopjim (Document Feeder): minumum 150 flets
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Usb, Pc, Email, Network, pdf, jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	minimum 80 ppm
Karakteristikat e Faks'it:	Standard
Aneksi	Fotokopje me ngjyra prej 10-100 perdorues

Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4/A3
Shpejtesia e Printimit:	prej 20- 25 ppm A4
Kapaciteti mujor I printimit:	30,000 printime ne muaj
Memorja:	1 GB
Procesori:	512 mhz
Hard Disk:	250 GB
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 600 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	5 deri ne 10 sekonda bardh e zi dhe me ngjyra
Kapaciteti I fleteve hyrese:	2 sirtare te letres me nga 500 flete; kapaciteti I fleteve hyrese per kopjim (Document Feeder) mininum 100 flete
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Usb, Pc, Email, Network, pdf, jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	minimum 50 ppm
Karakteristikat e Faks'it:	Standard

Pershkrimi	Fotokopje me ngjyra prej 100-200 perdorues
Karakteristikat	Printim, kopjim, skanim, faks - A4/A3
Shpejtesia e Printimit:	prej 50 - 60 ppm
Kapaciteti mujor I printimit:	200,000 printime ne muaj
Memorja:	2 GB
Procesori:	800 MHz
Hard Disk:	250 GB
Rezolucioni I Printimit:	1200 x 1200 dpi
Koha e printimit te faqes se pare:	4 deri ne 8 sekonda bardh e zi dhe me ngjyra
Kapaciteti I fleteve hyrese:	2 sirtare te letres me nga 500 flete; kapaciteti I fleteve hyrese per kopjim minimum 100 flete
Printimi/Kopjimi ne te dy anet e fletes:	Standard
Konekcioni:	10/100/1000Base-T Ethernet, High Speed USB 2.0
Karakteristikat e Skanimit:	Usb, Pc, Email, Network, pdf, jpeg
Shpejtesia e Skanimit:	minimum 80 ppm
Karakteristikat e Faks'it:	Standard

1. Karakteristikat e lartcekura janë karakteristika minimale të cilat duhet të ofrohen.
2. Pajisjet e ofruara nga OE duhet ti zëvendësojnë pajisjet aktuale që janë në përdorim të institucioneve në baze të një studimi të fizibilitetit që kompania obligohet të kryej para se ti instalojë dhe konfiguruj këto pajisje në institucione.
3. Operatori ekonomik duhet të ofrojë pajisje me shpejtësi të printimit mbi 60 faqe për minutë vetëm nëse kërkohet specifikisht nga AK dhe në marrëveshje të plotë me AK.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të pajisjeve dhe materialeve harxhuese (toner, drum). Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në anulim të kontratës me autoritetin kontraktues.

1. Specifikimet teknike te Softuerit menaxhues dhe kontrollues për Printim, Fotokopjim dhe Skanim

Solucioni softuerik duhet te kontrolloje qasjen në printera, fotokopje, skanera dhe ne pajisje multifunkionale, duhet qe te menaxhoje alokimin e kostove me qellim te raportimit si dhe për qëllime te buxhetimit.

Softueri menaxhues duhet qe te mundësojë një ambient te sigurte te printimit dhe te dokumentimit ne mënyrë qe t'iu ndihmoje institucioneve që ta kontrollojnë shfrytëzimin e pajisjeve si dhe shpenzimet e printimit, fotokopjimit dhe skanimit.

Parametrat e sigurisë

- Te gjitha pajisjet duhet te jene te shfrytëzueshme vetëm nëpërmjet qasjes me karte ne pajisje për të gjitha funksionet e printimit, fotokopjimit dhe skanimit.
- Te gjitha pajisjet duhet te pajisen me lexues kartash qe të mundësojnë leximin e kartave për autorizim
- Aktualisht institucionet përdorin karta për hapjen e dyerve te ndërtesave dhe kartat mund te jene te llojit te ndryshëm andaj operatorët ekonomik duhet te ofrojnë lexues te kartelave qe janë kompatibil me te gjitha kartat ekzistuese qe janë ne shfrytëzim nga personeli.
- Vetëm pas autorizimit me karte ne pajisje, shfrytëzuesit mund te shohin dhe kontrollojnë dokumentet dhe aktivitetet tjera ne lexuesit e kartelave dhe mund te marrin dokumentin e printuar, fotokopjuar si dhe mund te përdorin funksionin e skanimit
- Shfrytëzuesit mund te japin urdhër për printim për dokumentet e tyre te ndryshëm dhe këto urdhra te printimit do te qëndrojnë ne server deri sa shfrytëzuesit të autorizohen me karte ne pajisje.
 - Shfrytëzuesit duhet te autorizohen në pajisje për të fotokopjuar apo skanuar në mënyrë që çdo aktivitet te regjistrohet në llogarinë e personit adekuat në server ku është i instaluar softueri menaxhues për printim ku pastaj se bashku me aktivitetet e printimit do të mund te gjenerohet raporti për te gjitha aktivitetet e kryera nga ai/ajo person adekuat si dhe mund te gjenerohet raport për te gjitha aktivitetet e një apo me shume pajisjeve te caktuara.
- Autorizimi me karte në pajisje duhet te mundësoje auditimin dhe kontrollin e personit qe i kryen funksionet e printimit, kopjimit dhe skanimit ne pajisje si dhe ne cilën pajisje po kryhen këto funksione nga ai/ajo.
- Lexuesit e kartelave duhet qe te jene kompatibil për pajisjet ekzistuese te cilat gjinden ne lokacionet e AK te cilat pajisje e kane si mundësi menaxhimin dhe kontrollimin e tyre nga serveri dhe (pajisjet ekzistuese te cilat e kane mundësinë e instalimit te lexuesit te kartelave dhe monitorimit nga serveri kryesore) si dhe për pajisjet e reja te ofruara nga OE.


Integrimi i softuerit menaxhues të printimit në serverët dhe ne infrastrukturën ekzistuese

- Ne institucionet e Republikës se Kosovës gjinden pothuajse te gjitha markat e pajisjeve si: HP, Canon, Dell, Konica Minolta, Ricoh, Xerox, Samsung, Lexmark, Kyocera, etj. dhe shume lloje/modele te ndryshme te pajisjeve te këtyre markave prandaj solucioni qe propozohet nga OE duhet te jete kompatibil me te gjitha

Llojet/modelet e pajisjeve për printim, skanim, fotokopjim ne mënyre qe te jete një solucion i vetëm softuerik i centralizuar për menaxhimin e printimit, fotokopjimit dhe skanimin ne Qendrën Shtetërore të të Dhënave (QSHDH), prej ku dhe do te kontrollohen dhe monitorohen te gjitha pajisjet dhe shfrytëzuesit e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës sa i përket aktiviteteve për printim, fotokopjim dhe skanim.

- Softueri menaxhues i printimit duhet te përkrahë platformën Microsoft Windows sepse Qeveria e Republikës se Kosovës përdorë platformën Microsoft në pothuajse te gjithë kompjuterët dhe serverët në të gjitha institucionet.
- Softueri menaxhues duhet te integrohet me Active Directory ekzistues ne institucionet e AK.
- Softueri menaxhues duhet te suportoje databazat Oracle dhe SQL
- Softueri duhet te ketë mundësinë e integritimit me terminal serverët apo aplikacionet te cilat disa prej institucioneve mund te i kenë për përdorim te brendshëm.
- Softueri duhet te ketë kapacitet te monitoroje, kontrolloje dhe menaxhoje numrin e nevojshëm te institucioneve si shfrytëzues te kësaj kontrate (LOT-i).
- Softueri duhet te instalohet ne Qendren Shtetërore te te Dhenave se Republikes se Kosoves apo në institucionet që kane infrastrukture të ndare nga QSHDH-ja, ku për këtë qëllim do te krijohen një ose disa server virtual me resurse te mjaftueshme qe do ti nevojitet softuerit për funksionim,
- Softueri duhet te ketë mundësinë e menaxhimit te serverëve te ndryshëm në bazë të serverëve qe institucionet e Republikes së Kosoves momentalisht i kane ne dispozicion.
- OE duhet qe te trajnoj ekipin e AK për administrim te softuerit i cili do te jete i instaluar në infrastrukturen e AK, si dhe duhet te ofroj udhezues/manuale per përdorim.
- OE nuk mund te ketë qasje ne server apo softuer nga jashtë ne asnjë mënyrë te vetme dhe çdo aktivitet qe do të kryhet, duhet te kryhet brenda lokacionet që do te jete i caktuar për administrim dhe menaxhim te softuerit menaxhues.
- Te gjitha aktivitetet e pajisjeve dhe shfrytëzuesve duhet të menaxhohen, kontrollohen dhe monitorohen nga QSHDH apo Institucioni ku do te jete i instaluar softueri menaxhues për printim. Instalimi i moduleve shtese mund te lejohet vetëm ne rastet kur Institucionet e caktuara mund te ketë shume lokacione (PSH Komuna e Prishtines) atëherë nëse operatori ekonomik dhe softueri i ofruar e ofrojnë mundësinë e instalimit te ndonjë modulit shtese te softuerit baze ne këtë komunë i cili është pjesë e softuerit baze dhe i cili modul do te mund ti ndihmoj softuerit qe aktivitet te kryhen me shpejte ne këtë institucion dhe/ose komunë te caktuar! OE duhet te specifikojte ne ofertën e tyre arkitekturën e softuerit për menaxhimin e te gjitha institucioneve dhe se duhet te ceket se mënyra e arkitekturës (e centralizuar ne një modul te vetëm apo e decentralizuar ne disa module dytësore te cilat komunikojnë me softuerin baze i cili do te instalohet ne QSHDH apo Institucionin që ka infrastrukture të ndare).
- Pas instalimit dhe konfigurimit te softuerit, OE duhet te dokumentojte tek personat përgjegjës te AK te gjithë procesin e instalimit dhe konfigurimit te softuerit si dhe arkitekturën e instaluar te softuerit dhe menaxhimit te pajisjeve ne forme te shkruar tekstuale dhe ne forme grafike me diagrame te ndryshme te arkitekturës se punës se softuerit për institucionet e përfshira ne projektin ne fjale, gjithashtu keto duhet të ceken edhe në PMN.

- Softueri duhet te ofroje instalimin e shpejte te drajverit te pajisjeve me metodën “one step installation” ne mënyrë qe gjate integritit te mos afektohen përdoruesit dhe/apo institucionet.
- Softueri duhet te ofroje mundësinë e krijimit te llogarive te personave përgjegjës për secilin institucion. Personat përgjegjës për menaxhimin e pajisjeve, përdoruesve, kartelave, raporteve etj., duhen te kenë qasje vetëm për institucionin te cilin e menaxhojnë dhe të i kenë të ndara përgjegjësitë sipas kërkesave të AK.
- OE duhet te ofroje solucion ne baze te 3 opsioneve te paraqitura në grafiken dhe sipas specifikacioneve te paraqitura me poshtë:



Qendra Shtetërore e të Dhënave (QSHDH):

- Përfshinë minimum dy serverë. Te dy serverët përdoren për redundance.
- Te dy serverët (master dhe slave) duhet lidhur ne SQL serverë të ndryshëm për të siguruar redundancen.
- Konekcioni në domain controller bëhet online tek server slave ndërsa te dhënat për përdoruesit janë te kopjuara (replikuara) ne mes te Slave serverit dhe Master serverit.

1. Institucioni – Infrastruktura A: Institucionet me shume printime (mbi 600,000 printime ne muaj).

Dy servere duhet instaluar lokalisht. Të gjithë urdhrat për printim duhet ruajtur lokalisht. Serverët lokal te instaluar në institucion i dërgojnë vetëm të dhënat statistikore tek Serveri Slave në Qendrën Shtetërore të të Dhënave (QSHDH), ndërsa të gjitha aktivitetet tjera janë te menaxhuara lokalisht përmes serverëve ne institucion, ndërsa këta serverë bëjnë autorizimin e përdoruesve lokal. Njëkohësisht duhet të mundësohet printimi direkt

në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.

2. Institucioni – Infrastruktura B: Institucionet me printime mesatare (300,000 deri ne 600,000 printime ne muaj).

Një server është i instaluar lokalisht. Të gjithë urdhrat për printim janë të ruajtur lokalisht. Serveri lokal i instaluar në institucion i dërgon vetëm të dhënat statistikore te printimit/kopjimit/skanimit/faksimit, ndërsa sa i përket autorizimeve ne pajisje, ato bëhen përmes serverit lokal apo edhe serverit kryesor Slave te vendosur ne QSHDH varësisht prej konfigurimit. Njëkohësisht duhet të mundësohet printimi direkt në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.

3. Institucioni – Infrastruktura C: Institucionet me pak printime (deri ne 300,000 printime ne muaj).

Nuk ka te instaluar server lokal. Te gjithë urdhrat për printim dërgohen tek serveri kryesor Slave si dhe të gjitha autorizimet njëkohësisht menaxhohen prej këtij serveri. Asgjë nuk ka të ruajtur lokalisht te gjitha aktivitetet menaxhohen përmes serverit kryesor Slave te vendosur ne QSHDH. Njëkohësisht duhet të mundësohet printimi direkt në IP te printerit/fotokopjes ndërsa i tërë procesi duhet të monitorohet nga softueri menaxhues.

Procesi i printimit:


- Mënyra e printimit duhet te jete e centralizuar dhe çdo printim duhet te shkoj nëpërmjet softuerit i cili duhet te instalohet ne QSHDH ose AK-së qe ka infrastrukture të ndare dhe assesi nuk mund te ketë printime direkte nga kompjuteri ne pajisjet e printimit (USB apo ndonjë mënyre tjetër e printimit) ne infrastrukturën e institucioneve te cilat do te jene te përfshira ne projekt ne mënyre qe çdo printim te jete i kontrolluar, monitoruar dhe llogaritur kostoja e çdo printimit nga çdo person i perfshire ne kete projekt.
- Operatori ekonomik duhet te ofroje solucion qe mbështete edhe printimin direkt ne printer për institucionet te cilat kane kërkesa te tilla, ndërsa te gjitha aktivitetet e përdoruesit dhe pajisjes (printim/kopje/skanim) duhet të monitorohen nga softueri menaxhues. Kjo mundësi duhet të ofrohet për të gjitha institucionet ku kërkohet printimi direkt
- Vetëm pasi që shfrytëzuesit të autorizohen në pajisje nëpërmjet lexuesit te kartës, pajisja do te fillojë procesin e printimit te dokumentit te caktuar.
- Asnjë përmbajtje e dokumenteve te printuara/skanuara nuk duhet te ruhet ne hard disqe apo memorje te paisjeve për printim/skanim pasi qe ky veprim te kryhet nga pajisja.
- Çdo dokument qe duhet printuar duhet te jete i enkriptuar, enkriptimi duhet te filloj prej momentit kur jepet urdhri për printim nga kompjuteri deri ne momentin qe dokumenti është i printuar
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve te printuara (përveç titullit dhe llojit te dokumentit – word, pdf, excel, etj) nuk mund të ruhet diku tjetër.

- OE duhet të ofroje mundësinë e limitimit të numrin të printimeve (bardh e zi apo me ngjyra) për shfrytëzuesit e veçantë për të cilët AK do të mund të kërkojë limitimin e numrit të printimeve. Në momentin e tejkalimit të këtyre limiteve, softueri duhet të mundësojë refuzimin e printimeve për shfrytëzuesin.

Procesi i skanimit:

- Para se fillohet një aktivitet i skanimit secili shfrytëzues duhet të autentikohet me karte në pajisjen adekuate për skanim (pajisje multifunksionale print/copy/scan)
- Përmes sistemit të autorizimit të përdoruesit në pajisje, softueri menaxhues duhet të ofroje mundësinë e skanimit vetëm në e-mail adresën e personit të autorizuar, dhe në këtë mënyrë skanimet bëhen vetëm tek e-mail i personit të autorizuar në mënyrë që të mos mundësohet të dërgohen skanimet direkt nga pajisja e skanimit apo pajisja multifunksionale tek ndonjë adresë jashtë institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës duke e mbrojtur kështu sigurinë e informacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Informatat e skanimeve duhet të shkojnë nëpërmjet softuerit i cili do të jetë i instaluar në QSHDH ose AK-së që ka infrastrukture të ndara në mënyrë që çdo muaj të mund të raportohet për të gjitha aktivitetet e skenimeve të muajit paraprak nga të gjithë shfrytëzuesit e pajisjeve.
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve të skanuara nuk mund të ruhet diku tjetër, përveç lokacionit (shared folder) ku kërkohet nga autoriteti kontraktues ose dërgim direkt në e-mail.
- OE duhet të ofroje mundësinë e limitimit të numrin të skenimeve për shfrytëzuesit e veçantë për të cilët AK do të mund të kërkojë limitimin e numrit të skenimeve. Në momentin e tejkalimit të këtyre limiteve, softueri duhet të mundësojë refuzimin e skenimeve për shfrytëzuesin.

Në diagramin më poshtë është i cekur procesi i skanimit që duhet të ofrohet nga OE:



Procesi i fotokopjimit:

- Ashtu si edhe printimi dhe skenimi, as fotokopjimi nuk mund të kryhet pa u autorizuar me kartelë në pajisjen adekuate për fotokopjim (pajisje multifunksionale print/copy/scan)

- Informatat e fotokopjimeve duhet të shkojnë nëpërmjet softuerit i cili do të jetë i instaluar në QSHDH ose AK-së që ka infrastrukture të ndare në mënyrë që çdo muaj të mund të raportohet për të gjitha aktivitetet e fotokopjimeve të muajit paraprak nga të gjithë shfrytëzuesit e pajisjeve.
- Asnjë informate mbi përmbajtjen e dokumenteve të fotokopjuara nuk mund të ruhet diku tjetër (sqarime shtese kërkohet nga OE për këtë pjesë)
- OE duhet të ofrojë mundësinë e limitimit të numrin të fotokopjimeve për shfrytëzuesit e veçantë për të cilët AK do të mund të kërkojë limitimin e numrit të fotokopjimeve. Në momentin e tejkalimit të këtyre limiteve, softueri duhet të mundësojë refuzimin e kopjimeve për shfrytëzuesin.

Redudanca

- OE duhet të ofrojë solucion softuerik i cili duhet të ketë redudance totale mbi ndonjë prishje eventuale të serverit baze ku është i instaluar softueri baze .
- Duke pasur një Redudance totale softueri nuk mund të ndalet asnjëherë së funksionuari duke e ditur që i gjithë procesi i printimit, skanimit dhe fotokopjimit duhet të shkojë nëpërmjet serverit kryesor, për këtë arsye duhet që serveri kryesor të jetë Fileover Cluster.
- Komunikimi në mes të këtyre serverëve duhet të jetë i enkriptuar.

Menaxhimi i pajisjeve:

- Softueri Menaxhues duhet të mundësojë monitorimin e pajisjes për prishjet aktuale dhe të mundshme, të planifikuara.
- Softueri Menaxhues përmes një e-maili të krijuar për dërgimin e notifikimeve (e-mailave të dërguara nga pajisjet për intervenim) të cilat dërgohen lokalisht brenda institucioneve, përdorë këtë e-mail për të dërguar këto kërkesa për intervenim tek OE për intervenimin aktual në terren.
- Softueri Menaxhues duhet të ketë mundësinë e raportimit të problemeve të pajisjeve brenda një kohe së caktuar (javore, mujore etj.) si dhe të ketë mundësinë e raportimit të përqindjes (%) së shfrytëzimit të pajisjes.

Raportimi:

- Softuare duhet të ketë mundësinë e raportimit në baze të aktiviteteve për secilin përdorues. Raportimet duhet të jenë të detajuara dhe duhet të paraqesin: kohën, aktivitetin, totalin për kohë të caktuar të ndare për secilin aktivitet, etj.
- Softuare duhet të ketë mundësinë e raportimit në bazë të institucioneve, duke përfshirë edhe raportet për departamentet të përfshira në këto institucione.
- Softuare duhet të ketë mundësinë e personalizimit të raporteve në baze të kërkesave të Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Softuare duhet të ketë mundësinë e përcaktimit të raporteve automatike të dërguara përmes e-mail tek personat e paracaktuar përgjegjës.

- Softuare duhet të ketë mundësinë e raportimit për statusin e pajisjeve (problemeve dhe kohën e shfrytëzimit të saj -UpTime) në baza kohore.
- Softuare duhet të ketë mundësinë e krijimit të raporteve të ndryshme sipas kërkesave të Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Raportimi duhet të jetë në atë mënyrë që në baza kohore (muaj, 3 muaj, etj.) të dërgohet në mënyrë automatike tek personat përgjegjës për secilin institucion, i detajuar në numrin e printimeve/kopjimeve/skanimeve për secilin institucion përkatës dhe departamenteve të saj. Këto raporte duhet të gjenerohen dhe dërgohen në mënyrë automatike në datat e caktuara.
- Faturimi duhet të bëhet nga OE i saktësuar sipas këtyre raporteve, për secilin institucion. Fatura duhet të përmbajë çmimin sipas kontratës me të gjitha taksat e Republikës së Kosovës të përfshira.

0016410



SCARDIAN

SIGURIME

NUMRI I POLICËS

016410

SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo
AGJENTI	SCARDIAN HQ Adresa: Rr. Perandori Justinjan Nr. 69
I SIGURUARI	ART HOUSE SHPK Adresa: SHESHI BILL KLINTON BLL 9/9
NUMRI I BIZNESIT	70273872
NUMRI FISKAL	600231774
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
TITULLI I KONTRATËS	SHFRYTEZIMI I FOTOKOPJEVE DHE PRINTERAVE ME QIRA -NIVELI LOKAL LOT 4
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	AQP 18 009 211
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	2284 ditë
SHUMA E SIGURUAR	20650 EURO
Nga:	26-03-2019 00:00:00
Deri:	26-06-2025 23:59:59
PRIMI I SIGURIMIT	1239.00
TVSH 18 %	223.02
PRIMI +TVSH 18%	1462.02
DATA E LËSHIMIT	2019-03-26 09:59:12

VËREJTJE: NR I BRENDSEHEM UA/ 2016 18 6489 211. NR RENDOR I KONT. 02/19 DPQ

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo policë sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga I Siguruarit/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruarit/përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

(emri, mbiemri, nënshkrimi)



Pjesë përbërëse e pollcës: 016410

Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: ART HOUSE SHPK, SHESHI BILL KLINTON BLL 9/9
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE: NR I BRENDSEHEM UA/ 2016 18 6489 211. NR RENDOR I KONT. 02/19 DPQ

Titulli i aktivitetit të prokurimit: SHFRYTEZIMI I FOTOKOPJEVE DHE PRINTERAVE ME QIRA -NIVELI
LOKAL LOT 4

Numri i prokurimit: AQP 18 009 211

SIGURIA E KONTRATËS

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **20650 EURO (NJEZET MIJE E GJASHTEQIND E PESEDHJETE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmëshja e njërit nga kushtet në vijim:


(a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmimeve të vërtetueshme objektiviht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe

(b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **20650 EURO** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen prej 26-03-2019 00:00:00 deri 26-06-2025 23:59:59

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:


SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë
Kosovë
2019-03-26 09:59:12

